*REPUBLIKA E SHQIPËRISË*

*BASHKIA TEPELENË*

MIRATOI

KRYETARI I BASHKISË

TËRMET PEÇI

NR 684 PROT

DATA 11.05.2018

# LISTA E SHERBIMEVE NE BASHKINE TEPELENE

Bashkia TEPELENE

GRUPI I PARE INFORMIM I QYTETAREVE

-SHERBIMET QE OFRON BASHKIA

-INFORMACION TË PËRGJITHSHËM NË LIDHJE ME TREGUESIT ZHVILLIMIT TË ZONËS

-INFORMACION ZYRTAR NË LIDHJE ME TREGUESIT ZHVILLIMIT TË ZONËS

Bashkia TEPELENE

GRUPI I DYTE KERKESA/ANKESA

-KËRKESË/ANKESË PËR PASTRIM, EVADIM DHE PËRPUNIM TË MBETJEVE URBANE

-KËRKESË/ANKESË PËR SHËRBIMIN E TRANSPORTIT QYTETAS

-KËRKESË PËR PËRFITIM SHPËRBLIMI PËR LINDJET

-KËRKESË PËR PAJISJEN ME VËRTETIM PËR NJË PAGESE TË KRYER

-KËRKESË PËR DRU ZJARRI

-ANKESA TË NDRYSHME NË LIDHJE ME TOKËN BUJQËSORE, PYJET, KULLOTAT

GRUPI I TRETE LEJE /LICENSA

-KËRKESË PËR MARRJEN E LEJES PËR USHTRIM AKTIVITETI SPECIFIK
-KËRKESË PËR MARRJEN E LEJES PËR PARKIM TË REZERVUAR

-KËRKESË PËR MARRJEN E LICENCËS PËR TREGTIMIN ME PAKICE TË KARBURANTEVE, GAZIT TË LËNGSHËM DHE TË NAFTËS PËR AUTOMJETET, VAJRAVE LUBRIFI KANTE DHE LËNDËVE DJEGËSE

-KËRKESË PËR MARRJEN E LEJES PËR USHTRIM AKTIVITETI TEJ KOHËS SË LEJUAR (24 ORË)

-KËRKESË PËR MARRJEN E LEJES PËR VENDOSJE REKLAME

-KËRKESË PËR MARRJEN E LEJES PËR PËRDORIMIN E HAPËSIRËS PUBLIKE PËR VEPRIMTARIE EKONOMIKE NË TREGJET PUBLIKE TË MIRATUARA

-KËRKESË PËR MARRJEN E LEJES PËR PËRDORIMIN E HAPËSIRËS PUBLIKE PËR VEPRIMTARIE EKONOMIKE NË AMBIENTET E INKUBATORIT TË BIZNESIT.

-KËRKESË PËR MARRJEN E LEJES PËR PËRDORIMIN E HAPËSIRËS PUBLIKE PËR USHTRIM VEPRIMTARIE EKONOMIKE GJATË EVENTEVE TË NDRYSHME PANAIRE, ETJ.

-KËRKESË PËR MARRJEN E LEJES PËR PËRDORIMIN E HAPËSIRËS PUBLIKE PËR SHËRBIM ME TAVOLINA JASHTË LOKALIT

-KËRKESË PËR MARRJEN E LEJES PËR PËRDORIMIN E HAPËSIRËS PUBLIKE PËR TREGTIM TË ARTIKUJVE TË NDRYSHËM

-KËRKESË PËR MARRJEN E LICENCËS PËR TRANSPORT MALLRASH PËR TË TRETË DHE ME QIRA BRENDA VENDIT

-KËRKESË PËR MARRJEN E LICENCËS PËR AGJENCI TRANSPORTI UDHËTARESH DHE TAKSI BRENDA VENDIT

Bashkia TEPELENE

-KËRKESË PËR MARRJEN E LICENCËS PËR TRANSPORTIN E UDHËTARËVE ME TAKSI

-KËRKESË PËR MARRJEN E LICENCËS PËR TRANSPORTIN PËR UDHËTARËT NË LINJA TË RREGULLTA RRETH QYTETASE

-KËRKESË PËR MARRJEN E LICENCËS PËR TRANSPORTIN E UDHËTAREVE NË LINJA TË RREGULLTA QYTETASE

-KËRKESË PËR MARRJEN E CERTIFI KATËS PËR TRANSPORT MALLRASH PËR LLOGARI TË VET BRENDA VENDIT

-KËRKESË PËR LEJE VARRIMI OSE ZHVARRIMI

-KËRKESË PËR T'U PAJISUR ME LEJE ZHVILLIMI

-KËRKESË PËR T'U PAJISUR ME LEJE NDËRTIMI

-KËRKESË PËR T'U PAJISUR ME CERTIFIKATATË PËRDORIMI

-PROCEDURA PËR NJOFTIM PËR PUNIME TË VOGLA

-KËRKESË PËR DHËNIEN E VËRTETIMIT OSE LEJES PËR FONDIN PYJOR DUKE I MARRË ME QIRA PËR AKTIVITETE TË NDRYSHME.

Bashkia TEPELENE

GRUPI I KATERT KËRKESË PËR T'U PAJISUR ME DOKUMENTACION

-KËRKESË PËR TU PAJISUR ME DOKUMENTACIONIN ARKIVOR

-KËRKESË PËR T'U PAJISUR ME DOKUMENTACIONIN ARKIVOR TEKNIK

-KËRKESË PËR NXJERRJEN E DETYRIMEVE E DETYRIMEVE TË SUBJEKTEVE TREGTARE

-KËRKESË PËR NXJERRJEN E DETYRIMEVE TË SUBJEKTEVE FAMILJARE

-KËRKESË PËR VËRTETIM QË NUK KA DETYRIME VENDORE

-KËRKESË PËR REDUKTIM TË TAKSËS FAMILJARE

-KËRKESË PËR RISHIKIM OSE KORRIGJIM TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

-KËRKESË PËR MARRJE ME QIRA TË ASETEVE TË BASHKISË

-KËRKESË PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE DHE OBJEKTEVE TË KTHYERA NË FOND BANESASH

-KËRKESË PËR APROVIM TË DEKLARATËS PARAPRAKE

-KËRKESË PËR PAJISJEN ME VËRTETIMIN E PASTËRTISË PËR LEJE NDËRTIMI

-KËRKESË PËR PAJISJEN ME VËRTETIMIN E PASTËRTISË PËR LEJE PËRDORIMI

-KËRKESË PËR PAJISJA ME VËRTETIMIN PËR FI LLIMIN E PUNIMEVE

-KËRKESË PËR PAJISJEN ME VËRTETIMIN E PASTËRTISË TË SHESHIT TË NDËRTIMIT PARA MARRJES SË LEJES SË NDËRTIMIT

-PROCEDURA PËR PAJISJEN ME FATURË PËR PAGESË

-KËRKESË PËR PAJISJE ME AKTIN E MARRJES NË PRONËSI TË TOKËS BUJQËSORE TË ISH-KOOPERATIVAVE

-VËRTETIM PËR POSEDIMIN E TOKËS BUJQËSORE NË PËRDORIM.

-KËRKESË PËR KONTRATË QERAJE LIDHUR ME PYJET DHE KULLOTAT

Bashkia TEPELENE

GRUPI I PESTE SHERBIME SOCIALE

-KËRKESË PËR PËRFI TIMIN E NDIHMA EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJE

- KËRKESË PËR PËRFI TIMIN E NDIHMA EKONOMIKE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFI ZUAR

- KËRKESË PËR QËNDRIM NË QENDRAT REZIDENCIALE ( SHTEPI TE MOSHUARVE, FEMIJEVE)

- MBROJTJA NDAJ DHUNËS NË FAMILJE

- KËRKESË PËR PAJISJE ME VËRTETIM BANIMI

-KERKESE VËRTETIM PËR SAKTËSIMIN E EMRIT

- KËRKESË PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT TË KËRKESËS SË STREHIMIT

- KËRKESË PËR PAJISJE ME VËRTETIM BASHKËJETESE

- KËRKESË PËR LËSHIM AUTORIZIMI PËR PËRFAQËSIM PËR TËRHEQJE PENSIONI APO NDIHME EKONOMIKE

- KËRKESË PËR VËRTETIM FAKTI ANËTAR I ISH KOOPERATIVËS BUJQËSORE DERI ME 01 GUSHT 1991

- KËRKESË PËR KONFIRMIM KUFIZIMI PRONE PRIVATE ME PRONE SHTETI

-KERKESE PER TAKIME ME TE AFERMIT NE IEVP

Bashkia TEPELENE

SPJEGIME

"**Kërkesë**" është akti zyrtar ose një formë lutje me shkrim ose verbale që i drejtohet institucionit të bashkisë për të përfi tuar nga një shërbim i caktuar ose nga një e drejtë e personit kërkues.

**"Ankesë"** është një deklaratë ose një formë e shprehur e një problematike e adresuar ndaj institucionit të bashkisë, i cili ka kompetencën për të zgjidhur këto problematika.

**Leje/Licenca/Autorizime:**

**"Licencë" është akti administrativ**, që i njeh titullarit të saj të drejtën të fi llojë e të ushtrojë tipin e veprimtarisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të dhe në legjislacionin shqiptar.

**"Autorizim" është akti administrativ**, që i njeh titullarit të saj të drejtën të kryejë një apo disa veprime, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të dhe në legjislacionin shqiptar.

**"Leje" është akti administrativ,** që i njeh titullarit të saj të drejtën të përdorë një të mire publike, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të dhe në legjislacionin shqiptar.

Bashkia TEPELENE

**Kërkesë për dokumentacion:** Kjo kategori përfshin kërkesat drejtuar bashkisë nga qytetarët apo bizneset për tu pajisur me një dokument, i cili përfaqëson një shkresë zyrtare që shërben për të dëshmuar ose për të vërtetuar diçka. Këtë të drejtë qytetarët apo bizneset e kanë gjithashtu të garantuar bazuar në ligjin për të drejtën e informimit.

Çdo person ka të drejtë të tërheqë një dokument origjinal ose një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit për t'u njohur me një informacion public (dokumenta arkivore, dokumenta teknik në lidhje me sheshet e ndërtimit etj). Gjithashtu, bazuar në legjislacionin shqiptar cdo person ka të drejtë të pajiset me vërtetim për një status të caktuar të tij (vërtetim se ka paguar të gjitha detyrimet e tij vendore, vërtetim për njohjen e tokës bujqësore etj.).

**Shërbimet sociale:** Shërbimet sociale dhe familjare përfshijnë ofrimin e drejtpërdrejtë të përkujdesjes sociale, këshillimit ose në raste e veçanta, ndihmë materiale për njerëzit në nevojë sociale. Ndihma materiale nënkupton sigurimin e parave, strehimit të përkohshëm, ushqimit, pagesës së shpenzimeve mjekësore, veshmbathjes ose çfarëdo nevoje tjetër të domosdoshme materiale urgjente për të cilën nuk ka burim tjetër në dispozicion.

Bashkia TEPELENE

Në kuadër të procesit të decentralizimit janë transferuar disa funksioneve të reja në nivel vendor, sic janë shërbimet që lidhen me tokën bujqësore, pyjet dhe kullotat. Në lidhje me shërbimin pyjor, bashkia kujdeset për vlerësimin e sipërfaqes së fondit pyjor e kullosor duke propozuar llojin e veprimtarive që mund të ushtrohen në sipërfaqet pyjore dhe kullosore duke përgatitur studime të detajuara. Bashkia ka në kompetencë të japë në përdorim sipërfaqen pyjore në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke mbrojtur mjedisin, natyrën dhe biodiversitetin në këto sipërfaqe.

Gjithashtu, jep leje për shfrytëzimin ekonomik të pyllit (të lëndës drusore, bimëve mjekësore e prodhimeve të tjera dytësore, pyjore), si dhe kullotja e bagëtive për nevojat e banorëve sipas kritereve dhe standardeve të përcaktuara në ligj.

Në lidhje me bujqësinë, bashkia është përgjegjëse për administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit për të plotësuar nevojat për ujë, për të larguar ujin e tepërt dhe për të parandaluar grumbullimin e ujit. Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes realizohet në mënyrë të tillë, që çdo fermer të marrë ujë në kohën dhe sasinë e kërkuar është një nga detyrat kryesoretë kësaj drejtorie. Gjithashtu një nga detyrat e bashkisë në fushën e bujqësisë është administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme etj

Bashkia TEPELENE